



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Br.No.	01 / 1382	
DATA	26-10-2022	
	PRISHTINË - A	

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 10, nenit 13 paragrafi 2 dhe nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 03/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 20 tetor 2022,

Miraton:

RREGULORE NR. 10/2022

PËR PROCEDURËN DISIPLINORE PËR ANËTARËT E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat për zbatimin e procedurës disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit, duke përfshirë procedurën e hetimit, pezullimin dhe rekomandimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin:

- 1.1. **Ligji** - Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.2. **Këshilli** - Këshillin Gjyqësor të Kosovës, siç është përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.3. **Anëtar i Këshillit** - kryesuesi, zëvendës kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të Këshillit, siç është përcaktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- 1.4. **Njësia** – Njësia për Inspektim Gjyqësor;
- 1.5. **Komisioni** - Komisionin Disiplinor të themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit, sipas

dispozitive të përcaktuara me Ligj dhe këtë rregullore;

1.6. **Subjekti i hetimit** – anëtarin e Këshillit ndaj të cilit mund të iniciohet dhe zhvillohet procedurë disiplinore; si dhe;

1.7. **Zyrtari kompetent** – zyrtarin e Njësisë për të ofruar mbështetje profesionale dhe administrative Komisionit Disiplinor.

2. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Neni 3

Parimet e procedurës disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit

1. Procedura disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit zbatohet duke u bazuar në parimet si në vijim:

1.1. **Parimi i Ligjshmërisë** - Procedura disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit zhvillohet në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve.

1.2. **Parimi i ruajtës së fshehtësisë zyrtare** – anëtari i Këshillit, komisioni dhe zyrtari kompetent, kanë për obligim të ruajnë fshehtësinë dhe të mos ndajnë informata privatisht apo publikisht (konfidencialitetin) lidhur me procedurën disiplinore deri në momentin kur vendimi për shqiptimin e sanksionit disiplinore ndaj anëtarit bëhet i formës së prerë. Shkelja e këtij parimi shërben si bazë për procedurë disiplinore ndaj anëtarit të Këshillit, komisionit apo zyrtarit kompetent.

1.3. **Parimi i mos diskriminimit të palëve** - nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, bindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të mos diskriminimit të palëve.

1.4. **Parimi i prezumimit të pafajësisë** - çdo anëtar i Këshillit, ndaj të cilit iniciohet procedura për sjellje disiplinore konsiderohet jo përgjegjës, derisa të vërtetohet shkelja e tij, me vendim të formës së prerë.

1.5. **Parimi i qasjes së barabartë** – anëtarët e Këshillit, komisionit dhe zyrtari kompetent duhet të veprojnë me transparencë, t'i garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës disiplinore, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë rregullore. Të drejtat

e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit.

- 1.6. **Parimi i proporcionalitetit** – një veprim i anëtarit të Këshillit, komisionit dhe zyrtarit kompetent në procedurë disiplinore, që për arsye të mbrojtjes së interesit publike kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personit që është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, nëse është i domosdoshme dhe i përshtatshme për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj.

Neni 4

Shkeljet disiplinore për anëtarin e Këshillit

1. Anëtari i Këshillit i nënshtrohen procedurës disiplinore në rast:
 - 1.1. të shkeljes së Kodit të Etikës për anëtarët e Këshillit;
 - 1.2. kur veprimet e tyre e kanë dëmtuar autoritetin e Këshillit dhe gjyqësorit;

Neni 5

Sanksionet disiplinore

1. Për shkelje disiplinore, Këshilli ndaj subjektit të hetimit, mund të shqiptoj sanksione disiplinore si në vijim:
 - 1.1. Vërejtje jo publike me shkrim;
 - 1.2. Vërejtje publike me shkrim;
 - 1.3. Zvogëlimi i përkohshëm të kompensimit/ pagës të pranuar si anëtarë i Këshillit deri në pesëdhjetë (50)% për një periudhë deri në një vit;
 - 1.4. pezullim nga detyra si anëtarë i Këshillit deri në marrjen e vendimit përfundimtar;
 - 1.5. shkarkim nga funksioni i anëtarit të Këshillit i zgjedhur nga gjyqësori; dhe,
 - 1.6. rekomandimin për shkarkim të anëtarit të Këshillit të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
2. Sanksionet disiplinore të cilat mund të rekomandohen nga Komisioni dhe shqiptohen nga Këshilli duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë parasysh:
 - 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga subjekti i hetimit;
 - 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore;
 - 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore;
 - 2.4. performancën dhe sjelljen e përgjithshme të subjektit të hetimit;
 - 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të subjektit të hetimit gjatë procedurës

disiplinore.

Neni 6 **Inicimi i procedurës disiplinore**

1. Këshilli mund të inicioj procedurën disiplinore në rast të:
 - 1.1. parashtrimin të ankesës në Këshill nga personi fizik apo juridik; si dhe,
 - 1.2. sipas detyrës zyrtare (ex officio) nga cili do anëtar i Këshillit.

Neni 7 **Forma e ankesës**

1. Ankesa pranohet me shkrim, në kopje fizike apo elektronike në Këshill dhe duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:
 - 1.1. identitetin e personit fizik ose juridik si dhe identitetin e anëtarit të Këshillit i cili e paraqet ankesën;
 - 1.2. identitetin e anëtarit të Këshillit i cili pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore;
 - 1.3. një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore;
 - 1.4. kohën e kryerjes së shkeljes së supozuar disiplinore, nëse nuk dihet periudha e saktë apo shkelja është kryer në vazhdimësi, periudha kohore brenda së cilës pretendohet se anëtarit i Këshillit e ka kryer shkeljen disiplinore.
2. Çdo ankesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, kur nga përmbajtja del se qëllimi i palës ankuese është të paraqes një pretendim për shkelje disiplinore nga ana e anëtarit të Këshillit.

Neni 8 **Pranimi dhe Regjistrimi i ankesës**

1. Këshilli e pranon dhe regjistron ankesën e paraqitur nga personat fizik, juridik dhe cili do anëtar i Këshillit në regjistrin përkatës fizik dhe elektronik.
2. Regjistri, përveç të dhënave të tjera duhet të përmbajë edhe informatat si në vijim:
 - 2.1. nr. rendor;
 - 2.2. numri i lëndës dhe data e pranimin;
 - 2.3. ushtruesi i ankesës (emri dhe mbiemri);
 - 2.4. emri dhe mbiemri i subjekti të hetimit ndaj të cilit paraqitet ankesa;
 - 2.5. shkeljen e supozuar disiplinore për të cilën pretendohet që subjekti i hetimit e ka kryer;

- 2.6. njoftimi për Këshillit për pranimin e ankesës (data e njoftimit);
- 2.7. vendimi i Këshillit (data e vendimit);
- 2.8. njoftimi i palës ankuese për vendimin e Këshillit (data e njoftimit); dhe,
- 2.9. sanksionin e shqiptuar (data e vendimit).

3. Çdo ankesë/kërkesë e pranuar në Këshill e merr numrin unik si në vijim:

3.1 AD/KD/01/2022.

Neni 9 **Shqyrtimi fillestar i ankesës**

1. Zyrtari kompetent është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së ankesës për shqyrtim fillestar nga Këshilli. Dosja duhet të përmbajë të gjitha shkresat, provat dhe deklaratat eventuale lidhur me ankesën.
2. Këshilli duhet të mbajë seancë për shqyrtimin e ankesës dhe vendos për themelimin e komisionit disiplinor brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës, nga dita e marrjes së ankesës.
3. Seanca e Këshillit për shqyrtimin të ankesës për fillim të hetimeve disiplinore, është e mbyllur.
4. Në rast se Këshilli vlerëson se ankesa nuk i përmban elementet e parapara me nenin 7 të kësaj rregullore apo nuk është e qartë, e plotë dhe përmban informata të papërcaktuara, kërkon nga pala ankuese të bëjë plotësimin e ankesës.
5. Ankuesi duhet t'i përgjigjet Këshillit brenda tetë (8) ditëve, nga dita e pranimit të kërkesës për plotësim.

Neni 10 **Veprimet procedurale të Këshillit pas shqyrtimit fillestar të ankesës**

1. Këshilli pas shqyrtimit fillestar të ankesës mund:
 - 1.1. ta hedhë ankesën;
 - 1.2. ta refuzon ankesën; dhe,
 - 1.3. të themeloj komisionin disiplinor.
2. Përjashtimisht paragrafit 1 të këtij neni, gjatë procedurës disiplinore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të komisionit, mund të pezulloj anëtarin e Këshillit i cili është nën hetime disiplinore nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes së supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve disiplinore.

Neni 11 **Hedhja dhe refuzimi i ankesës**

1. Këshilli mund:

- 1.1. ta hedhë ankesën nëse e njëjta nuk plotësohet nga pala ankuese dhe nëse ankesa është anonime;
- 1.2. ta refuzon ankesën nëse konstaton se është dukshëm joserioze ose e pabazuar.

2. Lidhur me hedhjen ose refuzimin e ankesës, Këshilli e njofton menjëherë me shkrim palën e cila e ka paraqitur ankesën dhe subjektin e hetimit ndaj të cilit është paraqitur ankesa.

Neni 12

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Në rast se ankesa nuk është hedhur apo refuzuar sipas nenit 11 të kësaj rregullore, brenda të njëjtit afat, Këshilli me vendim themelon komisionin për fillimin e hetimit disiplinor.
2. Vendimi i Këshillit me të cilin themelohet komisioni, përveç të tjerash duhet të përmbaj:
 - 2.1. të dhënat për subjektin e hetimit;
 - 2.2. të dhënat për përbërjen e komisionit dhe,
 - 2.3. të dhënat për ankuesin dhe përmbajtjen e ankesës;
3. Subjekti i hetimit dhe komisioni njoftohen me nga një kopje të vendimit të nxjerr sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 13

Vepra penale

1. Në rastet kur shkelja e supozuar disiplinore përmban elemente të veprës penale, komisioni sipas detyrës zyrtare ia referon çështjen Prokurorit të Shtetit si dhe e njofton Këshillin.
2. Në rastet kur Prokurori i Shtetit vendos të mos ndjekë penalisht shkeljen, ai duhet të njoftoj me shkrim komisionin lidhur me vendimin.
3. Referimi i çështjes tek Prokurori i Shtetit e suspendon procedurën disiplinore.
4. Në qoftë se referimi i çështjes tek Prokurori i Shtetit rezulton në dënim penal apo lirim nga akuza, Prokurori i Shtetit e njofton me shkrim komisionin mbi rezultatin e procedurës penale.

Neni 14

Komisioni Disiplinor

1. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të jetë anëtar gjyqtarë i Këshillit, dy (2) anëtarë të tjerë nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës, dhe dy (2)

anëtarë rezervë, prej të cilëve njeri vjen nga anëtarët gjyqtar të Këshillit kurse tjetri nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të Republikës së Kosovës.

2. Zgjedhja e anëtarit të rregullt dhe rezervë të komisionit nga radha e anëtarëve gjyqtar të Këshillit, bëhet përmes shortit. Anëtari i komisionit nuk mund të jetë nga gjykata e njëjtë nga e cila mund të vijë subjekti i hetimit dhe caktohet vetëm gjyqtari me mandat të përhershëm, ndaj të cilit nuk është duke u zhvilluar procedurë disiplinore si dhe nuk është shqiptuar sanksion disiplinore gjatë pesë (5) viteve të fundit.

3. Komisioni zhvillon procedurën disiplinore brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e themelimit. Me aprovimin e Këshillit dhe për shkaqe të arsyetuara ky afat mund të zgjatet edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera.

4. Në rast se gjatë procedurës disiplinore, komisioni gjen se subjekti i hetimit ka kryer edhe shkelje tjera, ai njofton Këshillin dhe kërkon aprovim për zgjerimin e hetimit si dhe shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurës disiplinore.

5. Anëtari i Këshillit, i cili është subjekt i procedurës disiplinore nuk merr pjesë në diskutimet apo votimet për çështjen e tij.

6. Në momentin kur vendimi i Këshillit bëhet i formës së prerë, pushon funksioni i komisionit përkatës.

Neni 15 **Konflikti i Interesit**

1. Kryesuesi, anëtarët e Këshillit, komisioni dhe zyrtari kompetent, para dhe gjatë gjithë zhvillimit të procedurës hetimore dhe disiplinore, apo në momentin kur paraqiten rrethanat të cilat mund të rezultojnë më konflikt të interesit, janë të obliguar të njoftojnë me shkrim Këshillin, respektivisht kryetarin e komisionit.

2. Në çdo kohë palët mund të i drejtohen Këshillit, respektivisht kryetarit të komisionit dhe t'i kërkojnë përjashtimin kur paraqiten rrethanat të cilat mund të rezultojnë me konflikt të interesit. Kërkesa duhet të jetë e arsyetuar mirë dhe të shpjegojë bazën mbi të cilin ngritët dyshimi.

3. Në të gjitha rastet kur paraqitet konflikti i interesit, ndërpritet procedura disiplinore, deri sa të vendoset për konfliktin e interesit.

4. Këshilli vendos për rastet e konfliktit të interesit.

5. Subjekti për të cilin është paraqitur konflikti i interesit nuk do të jetë pjesë e vendim -marrjes lidhur me vendosjen për konflikt të interesit.

6. Subjekti për të cilin është konstatuar konflikti i interesit do të përjashtohet nga procedura disiplinore dhe i njëjti do të zëvendësohet.

7. Këshilli, vendos për çështjen jo më vonë se pesëmbëdhjete (15) ditë nga dita e pranimi të kërkesës.

Neni 16 **Procedura Disiplinore**

1. Komisioni pas fillimit te procedurës disiplinore me shkrim e njofton subjektin e hetimit lidhur me:

- 1.1. përbërjen e komisionit;
- 1.2. shkeljen e supozuar për të cilën hetohet;
- 1.3. të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me ankesën;
- 1.4. të drejtën e qasjes së plotë në dosjen disiplinore;
- 1.5. të drejtën për t'u informuar rreth zgjerimit të hetimeve;
- 1.6. të drejtën për të paraqitur prova, dokumente apo dëshmitarë;
- 1.7. të drejtën për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës gjatë procedurës disiplinore.

2. Në rast se subjekti i hetimit e autorizon avokatin mbrojtës për ta përfaqësuar, me shkrim duhet ta njoftoj komisionin.

3. Pasi komisioni t'i përfundoj hetimet disiplinore cakton seancë dëgjimore në të cilën ftohet subjekti i hetimit. Komisioni mund të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore në qoftë se një gjë e tillë rrjedh nga kompleksiviteti i rastit. Seanca dëgjimore është e mbyllur.

4. Subjekti i hetimit njoftohet me shkrim nga komisioni lidhur me datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës dëgjimore. Njoftimi lëshohet me autorizim të kryetarit të komisionit.

5. Ftesa dhe shkresat e tjera i dorëzohen personalisht subjektit të hetimit sipas rregullave të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

6. Me qëllim të qartësimit të ndonjë fakti relevant, komisioni ka të drejtë të kërkojë informata nga Këshilli, Sekretariati apo secila gjykatë, të cilat i përgjigjen pa vonesë.

Neni 17 **Zhvillimi i Seancës dëgjimore**

1. Kryetari i komisionit e hap seancën dëgjimore dhe konstaton:

- 1.1. numrin e lëndës;
- 1.2. datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës;

1.3. përbërjen dhe prezencën e anëtarëve të komisionit, subjektit të hetimit dhe përfaqësuesve të pranishëm;

1.4. zyrtarët e tjerë të pranishëm nga Njësia kompetente, me leje të kryetarit të komisionit.

2. Kryetari i komisionit konstaton nëse subjekti i hetimit ka vërejtje rreth përbërjes së komisionit.

3. Nëse subjekti i hetimit në procedurë paraprakisht e njofton komisionin për pamundësinë që të marrë pjesë në seancë, për rrethana dhe shkaqe të cilat komisioni i konsideron të arsyeshme, seanca shtyhet.

4. Nëse subjekti i hetimit nuk i përgjigjet dy (2) herë radhazi ftesës se dërguar në mënyrë të rregullt dhe nuk e arsyeton mos pjesëmarrjen në seancë dëgjimore, komisioni mund të mbaj seancën dëgjimore edhe pa prezencë të subjektit të hetimit.

5. Kryetari i komisionit, pas fillimit të seancës prezanton një përmbledhje të shkurtë të raportit me shkrim, paraqet të gjitha provat që mbështesin të gjeturat e parashtruara në raportin me shkrim dhe ia jep fjalën subjektit të hetimit.

6. Me përmbjlljen e administrimit të provave, subjekti i hetimit paraqet fjalën përfundimtare. Fjala përfundimtare mund t'i referohet dëshmimeve dhe provave tjera të pranuar.

7. Në çdo kohë gjatë procedurës disiplinore subjekti i hetimit mund të pranojë se ka bërë shkeljen disiplinore të paraqitur në raportin me shkrim.

8. Seanca dëgjimore incizohet me audio incizim, në të njëjtën mënyrë siç bëhet incizimi i mbledhjeve të Këshillit. Transkripti nga audio incizimi shërben si procesverbal në procedurë dëgjimore.

Neni 18 **Këshillimi dhe votimi**

1. Komisioni pas përfundimit të seancës, në të njëjtën ditë apo më së voni brenda shtatë (7) ditëve, voton lidhur me përgjegjësinë apo jo përgjegjësinë e subjektit të hetimit dhe për sanksionin e rekomanduar disiplinore, nëse konstaton se i njëjti është përgjegjës.

2. Komisioni vendos me shumicë të votave.

3. Mendimi mospajtues i ndonjërit anëtar të komisionit lidhur me përgjegjësinë apo jo përgjegjësinë e subjektit të hetimit dhe sanksioni i rekomanduar shënohet në procesverbal.

4. Në seancën për këshillim dhe votim, përveç anëtarëve të komisionit, merr pjesë edhe zyrtari kompetent dhe kur është e nevojshme edhe përkthyesi.

5. Në rast se komisioni konstaton se nuk ka shkelje disiplinore, e njofton Këshillin me gjetjet e raportit të komisionit.

6. Procesverbali për këshillim dhe votim përpilohet nga zyrtari kompetent, kurse nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe mbyllet në zarf. Ky dokument është konfidencial dhe i bashkëngjitet lëndës.

Neni 19 **Hartimi i raportit**

1. Komisioni harton raportin brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga data e mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim.

2. Raporti përveç të dhënave për subjektin e hetimit (emrin dhe mbiemrin e subjektit të hetimit, datën e themelimit të komisionit, parashtruesin e ankesës, datën e dorëzimit, emri, mbiemri dhe nënshkrimin e anëtarëve të komisionit) duhet të përmbaj edhe të dhënat si në vijim:

- 2.1. përmbledhjen e procedurave hetimore paraprake;
- 2.2. përmbledhjen e pretendimeve të parashtruesit të ankesës;
- 2.3. përmbledhjen e provave të mbledhura nga komisioni;
- 2.4. përmbledhjen e deklaratave të marra nga dëshmitarët;
- 2.5. përmbledhjen e deklaratës së marrë nga subjekti i hetimit;
- 2.6. përmbledhjen e provave të tjera të pranuar nga komisioni (nëse ka);
- 2.7. gjetjet e fakteve dhe konkluzioneve, fakte të kontestueshme dhe fakte të pa kontestueshme;
- 2.8. konstatimin dhe arsyetimin për përgjegjësinë apo jo përgjegjësinë disiplinore; si dhe,
- 2.9. rekomandimin për sanksionin disiplinor.

3. Raporti nënshkruhet nga kryetari i komisionit. Një kopje e raportit i dërgohet Këshillit dhe subjektit të hetimit. Konfirmimin mbi pranimin e raportit e siguron zyrtari kompetent me të cilin dëshmohet se Këshilli dhe subjekti i hetimit ka pranuar raportin e komisionit dhe i njëjti konfirmim i bashkëngjitet lëndës.

Neni 20 **Propozimi për shkarkim i anëtarit të Këshillit**

1. Në rast se komisioni ka gjetur se anëtari i Këshillit ka konsumuar shkelje disiplinore e cila paraqet bazë për shkarkimi, të njëjtin e rekomandon tek Këshilli për shkarkim.

2. Me rekomandimin e Komisionit, një anëtar i Këshillit që vjen nga gjyqësori mund të shkarkohet me anë me dy të tretat (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit .

3. Me rekomandimin e Komisionit, një anëtar i Këshillit i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me dy të tretat (2/3) të votave të anëtarëve të Këshillit, propozohet tek Kuvendi i Republikës së Kosovës për shkarkim.

Neni 21 **Procedura e ankimit**

1. Ndaj vendimit të Këshillit për shkarkim, subjekti i hetimit ka të drejtë në ankesë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Supreme në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

2. Ankesa ndaj vendimit të Këshillit ka efekt suspensiv dhe ndalon implementimin e atij vendimi, derisa të shqyrtohet ankesa.

3. Subjekti i hetimit, mund të ushtroj ankesë në rrethanat si në vijim:

3.1. në rast të zbatimit të gabuar të ligjit;

3.2. në rast të shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj; si dhe,

3.3 në rast të gabimit faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat e subjektit të hetimit në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës.

4. Gjykata Supreme vendos lidhur me ankesën.

5. Pas shqyrtimit të ankesës, Gjykata Supreme vendimin e Këshillit mund ta konfirmoj, ta ndryshoj atë apo rastin ta kthej në Këshill për rishqyrtim.

6. Në rast se Gjykata Supreme vendos ta kthej çështjen për rishqyrtim në Këshill. Këshilli është i obliguar që të vendos brenda afatit kohorë prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimi të vendimit nga Gjykata Supreme.

Neni 22 **Regjistrimi dhe publikimi i vendimeve përfundimtare**

1. Me përjashtim të sanksionit disiplinor, vërejtje jopublike me shkrim, të gjitha vendimet përfundimtare mbi sanksionet disiplinore publikohen pa vonesë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë në faqen zyrtare të Këshillit.


2. Sekretariati i Këshillit mbanë regjistër për vendimet përfundimtare.

Neni 23
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrje në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullore (01/2014) për Procedurën Disiplinore për Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë: 26 . 10 . 2022